



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR ZYRËN E KRYEMINISTRIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË
31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *udhëheqësi i ekipit Sabile Musa dhe anëtare e ekipit Laureta Matoshi Pozhegu*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Blerim Kabashi*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Qeverisja e mirë.....	21
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	30
Shtojca II: Letër Konfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Zyrës së Kryeministrit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç çështjeve në vijim:


Pagesat për projekte që nuk janë përfshirë në planin fillestar të buxhetit në vlerë prej 869,149€ janë paguar me vendime të Qeverisë nga fondi rezervë dhe nga ndarjet buxhetore shtesë gjatë vitit. Për këto pagesa nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për rregullsinë e këtyre shpenzimeve.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se nga kategoria e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht 2,174,676€, për projekte që kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime dhe subvencione.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Zyrës së Kryeministrit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se një proces auditimi mund të ndërmerret.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Pagesat për projekte që nuk janë përfshirë në planin fillestar të buxhetit në vlerë prej 869,149€ janë lejuar me vendime të Qeverisë nga shpenzimet e paparashikuara (fondi rezervë) dhe nga kursimet e fund vitit. Lidhur me këto pagesa, nuk ekzistojnë dëshmi të përshtatshme dhe të mjaftueshme nëse ato janë shpenzuar në pajtim me procedurat dhe kërkesat ligjore.

Pagesat kanë të bëjnë me rastet si në vijim:

(1) Qeveria me vendimin Nr. 03/58, të datës 24.07.2018¹ ka themeluar një Task forcë për pastrimin e ambientit në Kosovë. Me Vendimin e Qeverisë Nr. 21/62, të datës 28.08.2018 është aprovuar plani i aktiviteteve me buxhet në lidhje me aksionin “*Ta pastrojmë Kosovën*” për periudhën 15 shtator – 15 dhjetor 2018. Vlera e projektit ishte 815,035€. Në projekt përfshihet pastrimi i të gjitha komunave, eliminimi i afër 1000 deponive ilegale dhe pastrimi i mbeturinave në hapësirat publike. Për qëllime të këtij projekti, deri në fund të vitit 2018 janë kryer gjithsej pagesa në vlerë prej 806,838€.

Për realizimin e këtij projekti janë anashkaluar procedurat për subvencionimin e OJQ-ve, siç janë të përcaktuara me Rregulloren nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve. Me rastin e testim të pagesave, kemi vërejtur këto parregullsi:

- Nuk ka kontratë në mes ZKM dhe përfituesit të subvencionit OJQ-së “*Ta pastrojmë Kosovën*”, e cila do të përcaktonte përgjegjësitë dhe detyrimet e palëve në realizimin e këtij projekti. Nga plani i aktiviteteve shihet se MMPH duhej të merret me alokimin e mjeteve logjistike dhe financiare, ndërsa ZKM do të merrej vetëm me pjesën ceremoniale të organizimit, por në këtë rast ZKM ka kryer të gjitha pagesat;
- Pagesat ishin kryer vetëm në bazë të faturave të dorëzuara nga ana e OJQ-së përfituese. Përveç faturave, ZKM nuk ka raporte financiare dhe narrative të dorëzuara nga ana e përfituesit për arsyetimin dhe përshkrimin e saktë të artikujve të faturuar dhe aktiviteteve të kryera në kuadër të këtij projekti.

Në fund të aktivitetit, MMPH ka dorëzuar një raport përmbledhës për punët e kryera gjatë këtyre tre muajve, por jo edhe ndonjë raport financiar dhe ndonjë raport përshkrues për shpërndarjen e disa artikujve, siç janë kontejnerët dhe shportat; dhe

- Koordinator i Task Forcës nuk kishte raportuar në Qeveri për zbatimin e Planit operativ një herë në muaj, siç përcakton Vendimi i Qeverisë Nr. 03/58.

Për shkak të mungesës së raporteve më sipër, ne nuk jemi në gjendje të konfirmojmë rregullsinë e shpenzimit të këtyre fondeve.

Në dy rastet më poshtë, ishin kryer pagesa në vlerë prej 62,311€, nga i fondi i shpenzimeve të pa parashikuara (rezervat). Përveç shpenzimeve nga rezerva, lidhur me këto pagesa, janë identifikuar edhe dobësi tjera.

(2) Për mbulimin e shpenzimeve të rivarrimit sipas Vendimit Nr. 05/69, datë 16.10.2018, janë shpenzuar mjete financiare në shumë prej 32,000€ pa procedura të prokurimit. ZKM kishte një kontratë me një OE për rivarrim të heronjëve dhe për të cilën ka aplikuar të gjitha procedurat e prokurimit. Por, për të njëjtat shërbime ishte kontraktuar një operator tjetër. Lidhur me këtë

¹ Qeveria kishte marrë Vendim me Nr. 03/58 data 24.07.2018 për krijimin e Task forcës për pastrimin e ambientit në Kosovë për periudhën 15 shtator-15 dhjetor 2018. Task forca përbëhet prej: MMPH, ZKM, MZHE, MI, MASHT, MPMS, MFSK, MPB, MBPZHR, MSH si dhe Organizata “*Ta Pastrojmë Kosovën*” dhe Organizata “*Green Art Center*”.

rast, shpenzimet janë kryer pa aplikuar procedura të prokurimit dhe me çmime më të larta krahasuar me çmimet e OE me të cilin ZKM kishte kontratën e mëhershme.

- (3) Procedurat të ngjashme ishin zbatuar edhe me rastin e Organizimit të ceremonisë shtetërore, sipas Vendimit Nr. 01/62, datë 28.08.2018, ku janë shpenzuar mjete financiare në shumë prej 30,311€. Nuk ka raporte përcjellëse që do të përshkruanin më hollësisht mënyrën e këtyre shpenzimeve.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Zyra e Kryeministrit dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpenzimet në vlerë prej 2,174,676€ (Kodi ekonomik 31920) për Investime Kapitale, ishin bërë për financimin e projekteve që nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale. Këto ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kjo kategori. Kjo ka ndodhur pasi AUV-it, përkundër kërkesave të vazhdueshme çdo vit, nuk i janë ndarë mjete të mjaftueshme për Mallra dhe Shërbime, dhe Subvencione.

Vetëm pas përfundimit të vitit 2018, me miratimin e buxhetit për vitin 2019, fondet për këto projekte janë miratuar në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr.04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të

SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Zyra e Kryeministrit kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Lidhur me këto kërkesa, ne kemi rishikuar çështjet e mëposhtme:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 Për Shpenzimin Parave Publike, Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare dhe Rregulla nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin përfundimtar të prokurimit;
- Raportet tremujore; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me PFV, kemi identifikuar çështjet si vijon:

- Në PFV, neni 19.3.1- Pasuritë Kapitale (me vlerë mbi 1,000€) janë të nënvlerësuara për vlerën prej 1,230,450€. Në AUV janë pranuar pajisjet për asgjësimin e mbetjeve shtazore gjatë vitit

2018, por janë regjistruar me vonesë në SIMFK në vitin 2019, gjatë kohës sa ne ishim në procesin e auditimit;

- Te neni 20 – Raporti për avancet e pa arsyetuara ishte prezantuar 58,140€, ndërsa sipas shënimeve të Thesarit duhet të jetë 76,750€. Diferenca prej 18,610€ është avanc i shpenzuar me kredit kartela nga viti 2015 dhe sipas dokumentacionit të ZKM është mbyllur, por që nuk ishin proceduar nga ana e Thesarit. Pas dërgimit të draft raportit të auditimit nga ana jonë, ZKM kishte bërë barazimet e duhura me Thesarin. Vlera e avanceve të pa arsyetuara ka ndikuar në mosbarazimin e shënimeve në SIMFK dhe regjistrave kontabël të Zyrës së Kryeministrit gjatë vitit 2018.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare, për të cilat kemi dhënë edhe disa sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Te neni 13 – Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme – te burimi i fondeve, të hyrat e AKP-së të shpenzuara për kategorinë e investimeve kapitale ishin prezantuar si shpenzime nga të hyrat vetjake; dhe
- Te neni 14 – Raporti i ekzekutimit të buxhetit – tek pjesa e pranimeve - Për të hyrat vetjake dhe donacionet, në PFV ishte vendosur buxheti i planifikuar për shpenzim dhe realizimi i pagesave, në vend se të vendoset buxheti i planifikuar për grumbullim dhe realizimi i grumbulluar.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I ZYRËS SË KRYEMINISTRIT

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale, të cilat kanë ndikuar edhe në kualifikimin e opinionit.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 ²Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kabinetin e Kryeministrit dhe Koordinatorin e Task Forcës brenda një afati sa më të shpejtë duhet të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të realizimit të projektit “Ta pastrojmë Kosovën” dhe të sigurojnë të gjitha raportet financiare dhe raportet tjera të cilat konfirmojnë se të gjitha pagesat e kryera janë të bazuara dhe të mbështetura me dëshmi.

² Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj raportet edhe për pagesat që lidhen me dy rastet tjera që ndërlidhen me shpenzimet e varrimit dhe rivarrimit, për të cilat mungojnë dëshmitë e duhura.

Rekomandimi C1 Me rastin e përgatitjes së PFV, Sekretari i Përgjithshëm të siguroj se të gjitha pasuritë janë regjistruar dhe shpalosur në PVF.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrollin

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve në fuqi, performanca buxhetore mbetet fusha më shqetësuese lidhur me shpenzimin e fondeve publike sipas vendimeve të Qeverisë, duke anashkaluar kushtet dhe rregullat që duhet të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe ligjeve në fuqi. Buxheti fillestar kishte variacione të mëdha karahasuar me buxhetin final, çka shpalos dobësitë në planifikimin e buxhetit pa analizat e duhura. Disa pagesa nga investimet kapitale janë kryer gabimisht për Subvencione dhe Mallra e Shërbime, duke rezultuar me mbivlerësim të shpenzimeve për investime kapitale dhe vlerë të dobët për para.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit, menaxhimi i procedurave të prokurimit në pajtim me LPP, menaxhimi i pagesave në përputhje me çmimin e kontratës, shpenzimet e subvencioneve pa kontrata me përfituesit, dhënia e dyfishtë e subvencioneve përfituesve të njëjtë, monitorimi i dobët i kontratave, menaxhimi i pasurive, menaxhimi i pagave dhe menaxhimi i obligimeve të papaguara, janë problemet më të theksuara në ZKM.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	16,630,357	20,943,908	19,173,140	13,329,918	11,557,074
Granti i Qeverisë -Buxheti	16,307,803	18,733,714	17,765,550	12,448,459	10,517,645
Të bartura nga viti paraprak ⁴	0	100,126	93,386	88,405	62,827
Të hyrat vetjake ⁵	322,554	322,554	227,595	222,418	182,180
Të hyrat nga AKP	0	301,000	301,000	0	0
Donacionet e brendshme	0	19,547	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	1,466,967	785,609	570,636	794,422

Planifikimi i buxhetit ishte bërë pa analiza të mjaftueshme dhe gjatë vitit shihet se ka pësuar ndryshime të shumta. Siç shihet nga tabela, buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,313,552€ apo 26%, rritja e buxhetit final në raport me buxhetin fillestar vjen nga burimet si: donacionet vendore, donacionet e jashtme, të hyrat nga AKP, të hyrat e bartura nga viti paraprak gjithsej në vlerë prej 2,426,011€, rritja e buxhetit nga shpenzimet e paparashikuar/rezerva shtetërore ishte në vlerë 762,337€ si dhe rritja me Vendimet e Qeverisë nr. 02/70 dhe nr. 011/79 në vlerë prej 1,663,674€ nga transferet dhe ndarjet buxhetore shtesë.

Në vitin 2018, OB ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 19,173,140€, me një përmirësim 4% krahasuar me vitin 2017. Në veçanti, performancë e dobët e shpenzimeve vërehet tek donacionet e brendshme dhe të jashtme, ku mbi 700,000€ kanë mbetur donacione të pa shpenzuara.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	16,630,357	20,943,908	19,173,140	13,329,918	11,557,074
Pagat dhe Mëditjet	4,144,331	4,699,483	4,654,126	3,943,047	4,385,848
Mallrat dhe Shërbimet	4,639,108	6,477,013	5,058,899	2,423,306	2,732,415

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Të hyrat vetjake të AUV të pashepuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shërbimet komunale	143,248	111,824	95,502	84,626	110,677
Subvencionet dhe Transferet	1,995,000	3,710,633	3,584,573	1,358,085	1,502,811
Investimet Kapitale	5,708,670	5,944,955	5,780,039	5,520,854	2,825,323

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin buxhetor:

- Buxheti për shpenzime kapitale gjatë vitit, është realizuar 97% e buxhetit final. Buxheti për Investime kapitale për vitin 2018 përfshin 12 projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe asnjë projekt të ri për vitin aktual. Të gjitha projektet nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, prandaj nga kategoria e Investimeve kapitale janë paguar edhe furnizime dhe shërbime veterinarë që për nga natyra i takojnë kategorisë Mallra, Shërbime dhe Subvencione.
- Rritja e buxhetit për Subvencione dhe Transfere për 1,715,633€ është rezultat i vendimeve të Qeverisë nga kursimet buxhetore dhe shpenzimeve të paparashikuara – fondit rezervë për projektet e reja të cilat nuk janë të planifikuara me buxhet. Kjo rritje e buxhetit nuk ishte kalkuluar në pajtim me nevojat, për shkak se në fund të vitit kishin mbetur 126,060€ të pashpenzuara.
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 555,152€ dhe për mallra dhe shërbime për 1,832,553€ është rezultat i rritjes së pagave me vendim të Qeverisë për stafin politik dhe një pjesë të stafit civil. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin gjithashtu të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm, donacionet dhe buxhetin nga fondi rezervë me vendime të Qeverisë, për projektet e reja të cilat nuk ishin të planifikuara me buxhet.
- Buxheti për komunalë ishte reduktuar për 31,424€ si pasojë e dinamikës më të ulët të shpenzimit karshi buxhetit.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga AUV dhe ZKM në 2018 ishin 5,691,685€. Ato kanë të bëjnë me të hyra nga licencat, nga inspektimet sanitare, fito sanitare dhe veterinarë, të hyrat nga taksat për regjistrim biznesi dhe çertifikata, shitja e gazetës zyrtare etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	5,690,849	5,690,849	5,691,685	5,731,908	5,743,595
Totali	5,690,849	5,690,849	5,691,685	5,731,908	5,743,595

Në bazë të një marrëveshje me MF, të hyrat vetjake prej 322,554€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e AUV-it, kurse pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2018 janë realizuar 99.8% e të hyrave të planifikuara. Prej tyre 99.6% janë të realizuara nga AUV. Krahasuar me vitin paraprak, kemi të

njëjtin trend të realizimit të të hyrave. Ne ketë kategori kemi testuar 66 mostra për qëllime substanciale dhe pesë (5) mostra për qëllime të pajtueshmërisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të ZKM-së, të cilat ndërlidhen me përcaktimin e koeficienteve për paga, avancime dhe aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2018 ishte 4,699,483€, ndërsa realizimi i shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor ishte 4,654,126€ apo 99%. Me vendim të Qeverisë ka ndodhur ndryshimi i pagave për stafin politike dhe një pjesë të stafit civil, nga muaji qershor duke përfshirë pagesa retroaktive prej janarit të vitit 2018.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 6,588,838€. Prej tyre për periudhën Janar-Dhjetor në 2018 ishin shpenzuar 5,154,401€ apo 78%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të udhëtimit, shërbime kontraktuese, dreka zyrtare etj. Në këtë kategori kemi testuar 79 mostra për qëllime substanciale dhe gjashtë (6) mostra për qëllime të pajtueshmërisë. Si rezultat i vlerësimit të mostrave kemi identifikuar:

Çështja B1 - Të punësuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta pa procedura të rekrutimit

Gjetja Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149, neni 12 - emërimet me afat të caktuar për një periudhë me të shkurtër se gjashtë (6) muaj bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për detyrime, dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Nga pesë mostra të vlerësuara, kemi vërejtur se në tri raste nuk janë aplikuar procedurat e rekrutimit për marrëveshje për shërbime veçanta.

Rreziku Angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedurë dhe në mungesë të transparencës, rritë rrezikun për plotësimin e pozitave me staf jo kompetent që nuk kanë arsimin dhe eksperiencën e duhur për të kryer punët e tyre.

Rekomandimi B1 Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefi ekzekutiv i AUV duhet ndërmarrë veprime për t'u siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /Kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për 2018 për subvencione dhe transfere ishte 3,710,633€, dhe prej tyre ishin shpenzuar 3,584,573€. Buxheti në këtë kategori është rritur gjatë vitit me vendim të kryeministrit, nga kodi i rezervës shtetërore dhe është transferuar tek programi i Zyrës së Kryeministrit si dhe me vendime të Qeverisë për ndarje, transfere dhe rialokimeve ndërmjet kategorive të shpenzimeve të OB-ve për vitin 2018. Buxheti për subvencione dhe transfere menaxhohet dhe realizohet kryesisht nga programi Zyra për Çështje të Komuniteteve si dhe programi Zyra e Kryeministrit. Këto kanë të bëjnë me mbështetjen e aktiviteteve për subvencionimin e entiteteve jopublike.

ZKM kishte bërë pagesa në vlerë prej 6,750€ për angazhimin e praktikantëve nga fondi burimor i Buxhetit të Republikës Kosovës (BRK), ndërsa sipas marrëveshjes është dashtë të paguhen nga fondi burimor (57) i Qeverisë Norvegjeze. Pas diskutimit të këtij problemi, menaxhmenti i ZKM ka ndërmarrë masa menjëherë, dhe këto shpenzime janë rimbursuar nga Qeveria norvegjeze në fondin burimor të buxhetit të Kosovës.

Përveç projektit ta pastrojmë Kosovën, e njëjta OJQ më datën 18.10.2018 kishte nënshkruar marrëveshje në vlerë prej 30,000€ me Zyrën për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) sipas procedurave për thirrje publike "Mbrotja dhe Promovimi i të drejtave dhe interesave të Komuniteteve" për projektin me aktivitetet e njëjta me projektin "Ta pastrojmë Kosovën", eliminimin e deponive ilegale dhe mbeturinave në hapësirat publike. Pas diskutimit të këtij problemi, me datën 20.05.2019 kemi pranuar dëshmi mbi njoftimin së është marr vendimi për shkëputje të një anshme të kontratës.

Ne këtë kategori kemi testuar 52 mostra për qëllimi substanciale dhe 12 mostra për qëllime të pajtueshmërisë. Si rezultat i vlerësimit të mostrave kemi identifikuar:

Çështja B2 - Mangësi në dhënien dhe monitorimin e subvencioneve**Gjetja (a) Dhënia e subvencioneve për persona fizik në kundërshtim me vendimin**

Vendimi qeveritar me nr.10/33 për miratimin e programeve për komunitete, neni 11 pika 2 thekson se Sekretari i përgjithshëm i ZKM-së themelon komisionin për shqyrtimin e kërkesave dhe projekteve për ndarjen e subvencioneve për personat fizik dhe juridik. Ky komision bënë shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga personat fizik dhe juridik të cilët bëjnë kërkesë në ZÇK për përfitim të subvencioneve.

Për 51 raste të personave fizik me pagesë totale prej 318,500€, nuk është formuar komision për vlerësimin e këtyre kërkesave, edhe pse vendimet janë të nënshkuara nga Kryeministri. Procedimi i shpejtë pa procedura i këtyre pagesave, është bërë për shkak të ndjeshmërisë së kërkesave të tyre.

Sa i përket mbështetjes financiare ku është aplikuar vlerësimi nga komisioni, vlen të ceket se duke mos përfshirë rastet e domosdoshme për ndihmesë, tek subvencionet për persona fizik kemi hasur në dhënien e ndihmave që janë përdorë për meremetime luksi, siç janë: blerja e roletave dhe zbukurimi me fasadë. Konkluzioni është se jo të gjitha kërkesat janë vlerësuar me objektivizëm.

Rreziku Mangësitë e paraqitura në procesin e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, rrisin rrezikun për shpenzime jo racionale të parasë publike si dhe mos arritjen e objektivave me subvencione.

Rekomandimi B2 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të sigurojnë që të respektohen rregulloret në fuqi mbi shpenzimin e parasë publike dhe kriteret e përgjithshme të rregullores mbi dhënien e subvencioneve. Po ashtu, duhet të siguroj rritjen e aktiviteteve monitoruese, për të mundësuar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin sipas kërkesave të rregullores.

Çështja A2 - Përfitues i dy subvencioneve për të njëjtin aktivitet, si dhe mospërmbushja e detyrimeve nga marreveshja financiare paraprake.

Gjetja Sipas Rregullores nr. 04/2017 për kriteret, standardet, procedurat për dhënien e subvencioneve neni 10 pika 1.4 thekson se për tu kualifikuar për mbështetje financiare, aplikuesi duhet të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete.

Në kemi identifikuar së në dy raste për aktivitete të njëjta dy OJQ, kanë përfituar mbështetje financiare nga dy Organizat Buxhetore:

(a) Për aktivitetin integrimi i Goranve të rinjë, OJQ përfituese nga Kuvendi i Kosovës me datën 14.05.2018 ka marrë subvencion 4,995€, si dhe me datën 20.12.2018 nga ZÇK (Zyra për Çështje të Komuniteteve) e ZKM, shumën prej 5,000€. Në të dy rastet pagesat janë bërë për të njëjtin aktivitet.

(b) Për aktivitetin “promovimi i diversitetit kulturor dhe dialogu” nga MKRS me datën 30.04.2018 OJQ përfituese është subvencionuar me 3,980€, ndërsa nga ZÇK me datën 20.12.2018 ka marrë edhe 15,000€, për të njëjtin aktivitet.

Në kemi identifikuar, gjithashtu, se në dy raste për aktivitete të ndyshme dy OJQ kanë përfituar nga dy subvencione: një nga Koordinatori nacional për kulturë, rini dhe sport, dhe një nga ZÇK, pa i kryer detyrimet nga mbështetja financiare paraprake.

(a) Për aktivitetin “mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve, ZÇK me datën 30.10.2018 kishte nënshkruar kontratë për subvencionimin OJQ-së, dhe me 19.12.2018 kishte bërë pagesë në vlerë 15,000€. E njëjta OJQ me datën 18.12.2018 nga Koordinatori nacional për kulturë, rini dhe sport kishte pranuar pagesë në vlerë 9,000€ për aktivitetin “mbështetje financiare me qëllimi të forcimit dhe promovimit të dijes, sportit, kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik”.

(b) ZÇK me datën 22.10.2018 kishte nënshkruar kontratë me OJQ për aktivitetin “ndërtimi i së ardhmes përmes bashkëjetesës së komunitetve”, dhe me datën 19.12.2018 i është bërë pagesa në vlerë 17,000€. Periudha e zabtimit projektit ishte 10 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Zyra e Koordinatorit nacional për kulturë, rini dhe sport me datën 17.12.2018 kishte nënshkruar kontratë me të njëjtën OJQ për aktivitetin “ngritja e shkathtësive për të rinj përmes kampeve rinore” dhe ishte bërë pagesa në vlerë 9,000€. Të dy zyret janë nën menaxhimin e Zyrës së Kryeministrit. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos koordinimit të programeve në kuadër të ZKM.

Rreziku

Mangësitë e tilla rrisin rrezikun e shpenzimit jo racional të parasë publike dhe ndarjen jo të drejtë të subvencioneve.

Rekomandimi A2

Sekretari i përgjithshëm i ZKM-së, Drejtori i ZÇK-së dhe Koordinatori nacional për kulturë, rini dhe sport duhet të sigurojnë që shumat e përfituara në mënyrë të pa drejtë nga OJQ, t'i kthehen buxhetit të ZKM, dhe Zyra për Qeverisje të Mirë të monitoroj procesin e ndarjes së subvencioneve, në mënyrë që të parandalohet dhenia e tyre pa i përmbushur detyrimet nga marrveshja paraprake, si dhe të mos jepen subvencione të dyfishta për të njëjtin aktivitet.

Çështja A3 – Vonesa në nënshkrimin e marrëveshjeve për subvencione

Gjetja Sipas rregullores nr. 04/2017 për kriteret, standardet, procedurat për dhënien e subvencioneve neni 22 pika 1 thekson se ofruesi i mbështetjes financiare lidhë kontratë me përfituesin brenda 90 ditësh nga dita e mbylljes së thirrjes publike.

Në rastin tonë shtatë (7) nga marrëveshjet për mbështetje financiare të thirrjes publike “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të Komuniteteve” janë nënshkruar pas afatit të përcaktuar me rregullore, për shkak të mungesës së buxhetit, nënshkrimi i marrëveshjeve është shtyrë deri në fund të muajit tetor.

Rreziku Ndarja e subvencioneve para se fondet të jenë në dispozicion për shpenzime, rritë rrezikun që përfituesit të fillojnë aktivitetet dhe të krijojnë detyrime të cilat mund të sjellin implikime të ndryshme në realizimin e vet projekteve, si dhe përfituesit të mos mund t’i përmbushin obligimet e tyre ndaj të tjerëve.

Rekomandimi A3 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të siguroj që të respektohet korniza ligjore në fuqi, respektivisht të mos shpall thirrje publike, para se fondet buxhetore të jenë të disponueshme në llogari bankare.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,944,955€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 5,780,039€. Buxheti për Investime kapitale menaxhohet dhe shpenzohet nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (AUV) në kuadër të ZKM-së. Ato kanë të bëjnë me projektet si ndërtimi i objektit fabrikës së riciklimit, pajisje laboratorit veterinar dhe ushqimit, si dhe projektet mbrojtja e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve me anë të hulumtimit, diagnostikimit dhe vaksinimit kundër sëmundjeve infektive të kafshëve. Shpenzimet në vlerë prej 2,174,676.31€ (Kodi ekonomik 31920) për projekte që nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e Investimeve Kapitale. Kjo çështje është trajtuar në paragrafin 2.1 Opinioni i auditimit - Theksimi i Çështjes.

Ne këtë kategori kemi testuar 55 mostra për qëllime substanciale dhe 12 mostra për qëllime të pajtueshmërisë. Si rezultat i vlerësimit të mostrave kemi identifikuar:

Çështja A Tejkallim i vlerës së kontratës

Gjetja Nenit 38 i ligjit nr. 04/L-042 i LPP-së, kontratave publike kornizë u lejohej tejkallim të kontratës +/- 30% të vlerës së kontratës. Në rast se ky tejkallim e kalon vlerën prej 30 % të vlerës së kontratës së nënshkruar, edhe nëse kontrata publike kornizë ende është valide, ajo duhet të ndërpritet menjëherë.

Kontratat publike kornizë të titulluara “Shërbimet Veterinare në terren – Vaksinimi masiv tek gjedhet” ishin nënshkruar me datë 11.07.2016 në mes të shtatë kompanive veterinarë në vlerë totale prej 93,997€. AUV për shërbime veterinarë kishte paguar gjithsej 197,937€ për vitet 2016-2018. Tejkalimi i vlerës së kontratës ishte 103,940€ apo 110%.

Si shkak i këtyre tejkalimeve ishte pamundësia e parashikimit të sasive, sepse çdo vit numri i shumimit të kafshëve dhe nevojat për vaksinim të tyre janë të ndryshme dhe vlerësimet mund të jenë vetëm të përafërta.

Pas pranimit të drafraportit, AUV ka marrë masa të menjëhershme dhe ka ndërprerë të gjitha kontratat, ndërsa është në përfundim e sipër të procedurave të prokurimit për kontrata të reja. Këtë çështje do ta mbajmë nën vëzhgim gjatë auditimit të radhës.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara për pasuritë e organizatës. Vlera e pasurive mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte 6,979,262€, ndërsa nën 1,000€ ishte 221,100€.

Përveç çështjeve të potencuara tek kapitulli opinionioni i auditimit, nuk kemi ndonjë çështje tjetër për të raportuar.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Lidhur me paranë e gatshme, ZKM në PFV të vitit 2018 kishte prezantuar vlerën e avanceve të pa arsyetuara prej 58,140€. Çështjet që ndërlidhen me këtë fushë i kemi paraqitura te kapitulli Opinionioni i auditimit.

3.4 Të arkëtueshmet

Sipas PVF-ve 2018, ZKM ka shuma të pa arkëtuara të të hyrave në vlerë prej 1,007€, të cilat kanë të bëjnë me AUV, përderisa, në fund të 2017 shuma e këtyre llogarive ishte 37,197€. Në këtë kategori kemi ekzaminuar disa mostra ku kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Si rezultat i ekzaminimit të këtyre mostrave, nuk kemi kami ndonjë çështje për ta ngritur..

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 274,020€, ndërkaq në fund të vitit 2017 obligimet e papaguara ishin raportuar në vlerë prej 652,140€. Kahasuar me një vit më parë, vlera e obligimeve të papaguara është zvogëluar për 378,120€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Struktura e këtyre obligimeve u takon këtyre kategorive: Mallra dhe shërbime 168,837€, Subvencione dhe transfere 33,150€, Komunalitë 1,247€ dhe Investime kapitale 70,791€. Arsyet e mos kryerjes së pagesave sipas ZKM ishte pranimi i faturave me vonesë pas mbylljes së viti fiskal, si dhe mungesa e buxhetit.

Në këtë kategori kemi testuar pesë (5) mostra për qëllime substanciale dhe tetë (8) mostra për qëllime të pajtueshmërisë. Si rezultat i vlerësimit të mostrave kemi identifikuar:

Çështja B3 - Mangësi në prezantimin dhe pagesën e obligimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01-2013 -Shpenzimi i parave publike tek neni 37, OB obligohet që çdo faturë të pranuar, të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të faturës, dhe nëse obligimet nuk paguhet, atëherë ato duhet të raportohen si të papaguara.

Nga testimet tona kemi vërejtur se dy pagesat për rivarrime në vlerën prej 16,000€ secila, dhe furnizim për zyrë për 8,230€, nuk janë paguar në afatin e kërkuar. Mosparaqitja e obligimit ishte për shkak të mungesës së buxhetit dhe subvencionimit të aktivitetit të njëjtë nga njësi përkatese, kurse vonesat për pagesa janë për shkak të hyrjes në obligime pa procedura.

Rreziku Mos pagesa në kohë e borxheve mund të rezultojë me ndëshkime ndaj ZKM, ndërsa raportimi i mangët i obligimeve dëmton saktësinë e pasqyrave financiare dhe pamundëson planifikimin afatshkurtër të obligimeve..

Rekomandimi B3 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që obligimet e mbetura në fund vit duhet të raportohen saktë në PFV, dhe të gjitha faturat të dorëzohen me kohë në shërbimin e financave.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave

buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ZKM, veçanërisht në lidhje me performancën e organizatës për të ofruar vendimmarrje më të mirë, shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për fondet e shpenzuara. Menaxhmenti ka përgjegjësi jo vetëm për të marr vendimet përfundimtare, por gjithashtu për të siguruar që këto vendime janë marr si duhet dhe janë në interes më të mirë të organizatës.

Dobësitë më të theksuara në fushën e qeverisjes janë përfshirja me kohë e disa projekteve të reja në planin e buxhetit vjetor. Si arsye e kësaj, disa projekte gjatë vitit janë financuar nga fondi rezervë, por të cilat kanë mund të përfshihen me planin fillestar të buxhetit. Pagesat janë kryer nga fondi i shpenzimeve të pa parashikuara (rezervat) për rastet që nuk trajtohen si raste urgjente, nuk shpjegohen rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojat shtesë, dhe arsyet pse nuk janë parashikuar, siç përcakton neni 29 të LMFP.

Projektet e tilla kanë të bëjnë me projektet si vijon:

- Për kompensimin e Komisionit Shtetëror për *Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e kufirit Shtetëror me Malin e Zi* (Vendimi Nr. 07/32, datë 20.02.2018), janë shpenzuar mjete financiare prej 152,619€. Këto pagesa janë realizuar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve – Shërbimet tjera kontraktuese, të dedikuara për punën e anëtarëve të komisionit të emëruar në shtator të vitit 2017, ku përfshihen kompenzimet mujore, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e telefonit. Kërkesa për financimin e këtij komisioni ishte bërë në janar të vitit 2018.
- Për takimin e përbashkët të dy Qeverive, asaj të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë (Vendimi Nr. 03/76, datë 21.11.2018), janë shpenzuar mjete financiare në vlerë prej 119,407 € për këto qëllime: shpenzime të akomodimit dhe drekave 14,129€, për material shpenzues 58,120€, për furnizimin me karriga, tavolina, perde, tepisona, brendimi i shankut, tenda dhe artikuj tjerë 28,249€, furnizimi me foldera lëkure, tavolinë për 40 persona, kulla dhe elemente tjera prej stirpori janë bërë pagesa në vlerë 18,909€. Për artikuj që konsiderohen pasuri, ZKM ishte dashtë të zhvilloj procedura të veçanta të prokurimit. Pjesërisht disa nga artikujt që konsiderohen si pasuri, janë kthyer në ZKM, por jo të gjitha. Prandaj, në auditimin e radhës, ne do t'i ekzaminojmë nëse artikujt që trajtohen si pasuri (karrigat, tavolinat, perde, tepisona, tenda, etj) i janë kthyer ZKM-së dhe nëse të njëjtat janë regjistruar në regjistrat e pasurisë;
- Më tej, për punën e Këshillit Organizues për shënimin e *Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës* me 5, 6, 7 mars (Vendimi Nr. 04/29, data 13.02.2018), janë shpenzuar 59,293€. Të

gjitha shpenzimet janë kryer nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kryesisht prej nënkategorisë “shërbimet tjera kontraktuese”;

- Për realizimin e aktiviteteve për afirmimin dhe integrimin e Komunitetit Malazet në Kosovë (Vendimi Nr. 05/42, datë 19.04.2018), janë shpenzuar 40,000€. Pagesa të tilla bëhen çdo vit dhe nuk kanë karakter të natyrës urgjente, dhe nuk kanë arsye të paguhen nga fondi rezervë; dhe
- Për komunitetin kroat që jeton në Janjevë (Vendimi Nr. 10/44, datë 27.04.2018), janë shpenzuar mjete financiare prej 40,000€. Edhe këto pagesa nuk mund të konsiderohen me karakter të natyrës urgjente dhe mund të planifikohen me buxhet të rregullt.

Gjatë rishikimeve tona, kemi vërejtur se kanë munguar përgjigjet efektive ndaj rekomandimeve të auditimit. Komiteti i auditimit është i themeluar, mirëpo nuk i ofron mbështetje Njesisë së Auditimit të Brendshëm në njësitë vartëse si në AUV.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në ZKM ka një anëtar, dhe ndaras nga kjo njësi, vepron edhe Auditori i Brendshëm në AUV. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të auditimit të brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Njësia e auditimit të brendshëm në ZKM për 2018 ka planifikuar katër (4) auditime. Deri në dhjetor të vitit 2018, kjo njësi ka kryer tri (3) auditime të planifikuara dhe një me kërkesë të veçantë. ZKM kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve të NJAB dhe është në proces për zbatimin e tyre. Gjithashtu, NJAB ka përgatitur raporte gjashtëmujore për aktivitetet e saj në NJQH/AB në MF.

Njësia e auditimit të brendshëm në AUV për 2018 ka planifikuar pesë (5) auditime. Deri në dhjetor të vitit 2018, ka përfunduar planin në tërësi. AUV kishte përgatitur plan dhe raport për zbatimin e rekomandimeve të NJAB dhe është në proces të zbatimit të tyre. Gjithashtu, NJAB ka përgatitur raporte gjashtëmujore për aktivitetet e saj në NJQH/AB në MF.

Çështja A4 - Bashkëpunim i mangët i Komitetit të Auditimit me auditorin e AUV

Gjetja Komiteti i Auditimit është i themeluar në kuadër të ZKM. Në takimet e mbajtura gjatë vitit 2018, Komiteti i Auditimit nuk ka ftuar asnjë herë në takime Auditorin e AUV-së. Po ashtu, rekomandimet e auditimit të brendshëm janë zbatuar vetëm në një numër të vogël të rasteve nga ana e menaxhmentit.

Rreziku Mbikëqyrja e dobët e punës së auditimit të brendshëm në AUV, dobëson rëndësinë dhe rolin e auditimit të brendshëm, si dhe redukton fokusin e fushave për rishikim.

Rekomandimi A4 Kryeshefi i AUV duhet të mbështetë dhe ndihmoj aktivitetet operative në vazhdim, si dhe të siguroj pjesëmarrjen e AB në takimet e Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, në kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara, për të cilat kemi dhënë rekomandime specifike në fushat e veçanta.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të ZKM-së ka rezultuar në 14 rekomandime kryesore. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, tre (3) të mbyllur të pazbatuar dy (2) ishin në proces dhe tre (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it, duhet të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Veprime konkrete duhet të ndërmerren në koordinim edhe më MF, për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve përmes sigurimit të buxhetimit/shpenzimit dhe raportim të drejtë të tyre.	Duke marr për bazë kërkesat e vazhdueshme të AUV-it, MF e ka bërë korrigjimin me qarkoren buxhetore 2019/01.	Rekomandimi në proces të zbatimit.
2	Mallrat dhe Shërbimet	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it duhet të përmirësoj nivelin e kontrolleve në realizimin e shpenzimeve dhe të siguroj transparencë dhe zbatueshmeri të legjislacionit në angazhimin/rekrutimin e stafit.	AUV ka ndërmarr masa dhe nga 01.05.2018 nuk ka asnjë të punësuar me MSHV. Mirëpo në ZKM dhe njësitë tjera vartëse janë të punësuar me MSHV 92 nëpunës sipas PFV. Për të punësuarit me vendim të kryeministrit nuk janë aplikuar procedurat e rekrutimit.	Rekomandim i pazbatuar.
3		Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin ekzekutiv të AUV-it, duhet të forcojnë kontrollet në fushën e prokurimit, duke siguruar që çdo raport i vlerësimit të procesit tenderues të jetë i rishikuar/monitoruar dhe i nënshkruar nga Zyrtari i prokurimit.	AUV ka ndërmarr masa raporti i vlerësimit është nënshkruar dhe është vendosur ne e-prokurim.	Rekomandim i zbatuar.
4	Subvencione t dhe Transferet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj menaxhim efikas në fushën e subvencioneve duke vendosur kontrolle përkatëse në realizimin e tyre. Të siguroj rritjen e aktiviteteve	Çështjet e njëjta janë të përsëritura	Rekomandim i pazbatuar.

		monitoruese, për të mundësuar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin për mënyrën e shfrytëzimit të tyre, duke siguruar që qëllimet e synuara përmes subvencioneve janë arritur.		
5	Investimet Kapitale	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it, duhet të ndërmarrin hapa të duhur për forcimin e kontrolleve në këtë fushë të realizimit të shpenzimeve, duke siguruar transparencë dhe pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara më LMFPN-në, rregullat e Thesarit dhe vendimet përkatëse.	Menaxhmenti ka marr masa për kthimin e mjeteve. Kthimi i mjeteve është realizuar. Për pjesën e pa kthyer rasti është paditur.	Rekomandim i zbatuar.
6	Investimet Kapitale	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të forcojnë kontrollet në realizimin e shpenzimeve dhe të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPN-në dhe me rregullat e Thesarit.	Raste të tilla kemi identifikuar gjatë auditimit për 2018	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
7	Çështjet e përbashkëta	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të ngrisin kontrollet për të siguruar që të planifikohet dhe analizohen më në detaje buxhetet për aktivitetet e prokurimit ashtu siç parashihet me Ligjin e prokurimit publik dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik.	AUV ka ndërmarr masa dhe për vitin 2018 nuk kemi vërejtur mospërputhje të planit të prokurimit dhe realizimit. Mirëpo në ZKM janë vërejtur mospërputhje të planit për të gjitha shpenzimet me vendime të qeverisë.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
8	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet t'i rishikojnë kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si duhet dhe të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi.	Menaxhmenti ka marr masa, janë regjistruar pasuritë e projektit SIDA, megjithatë edhe gjatë vitit 2018 kemi identifikuar pasuri të	Rekomandimi në proces të zbatimit.

			paregjistruara, është trajtuare të çështja e opinionit.	
9	Të arkëtueshmet	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, dhe raportimit e saktë të tyre, duke siguruar pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuar me legjislacionin në fuqi si dhe të siguroj prezantim/shpalosje të saktë në PVF.	Gjate procesit të auditimit të vitit 2018, nuk kemi hasur në çështje të njëjta.	Rekomandim i zbatuar.
10	Obligimet e papaguara	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që aktivitetet operative dhe financiare aty ku është e mundur të zhvillohen para muajit dhjetor.	Obligimet për vitin 2018 janë zvogëluar,	Rekomandim i zbatuar.
11	Obligimet e papaguara	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhën brenda afatit ligjor, si dhe të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara bëhet i plotë dhe në përputhje me rregullat në fuqi.	Edhe këtë vit kemi vonesa në pagesa	Rekomandim i pazbatuar.
12	Detyrimet Kontingjente	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të sigurojnë se detyrimet kontingjente trajtohen me kujdes, të analizojnë shkaqet e ndodhjes së tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Në koordinim me Avokatin Shtetëror të sigurohen informata/dëshmi që të sigurohet përfaqësim adekuat i këtyre rasteve/lendeve.	Nuk kemi hasur në çështje të njëjtat	Rekomandim i zbatuar.
13	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Sekretari i përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk implementohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Është evidentuar progres në zbatimin e rekomandimeve. Megjithatë, përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e	Rekomandimi i mbyllur i pazbatuar.

			dhëna, një numër i tyre kanë mbete në proces të zbatimit dhe të pazbatuara.	
14	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Sekretari i Përgjithshëm së bashku me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it, në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, duhet të rishikojnë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në proceset e vitit aktual dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit.	Për vitin 2018 kishte raporte të NJAB	Rekomandim i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Rekomandimi A1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se është bërë një analizë për të përcaktuar dhe eliminuar shkaqet për opinion të kualifikuar dhe theksim të çështjes.		
2	PVF	Rekomandimi C1 Po ashtu, duhet që me rastin e përgatitjes së PFV, të siguroj se të gjitha pasuritë janë regjistruar dhe shpalosur në PVF, si dhe të shqyrtoj gjithë dokumentacionin e nevojshëm lidhur me sqarimin dhe arsyetimin e diferencave të shfaqura tek avancet, dhe të njëjtat të barazohen me gjendjen e Thesarit.		
3	Mallrat dhe shërbimet	Rekomandimi B1 Kryeshefi ekzekutiv duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /Kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.		
4	Subvencione dhe Transfere	Rekomandimi B2 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të sigurojnë që të respektohen rregulloret në fuqi mbi shpenzimin e parasë publike dhe kriteret e përgjithshme të rregullores mbi dhënien e subvencioneve. Po ashtu, duhet të siguroj rritjen e aktiviteteve monitoruese, për të mundësuar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin sipas kërkesave të rregullores.		
5	Subvencione t dhe transferet	Rekomandimi A2 Sekretari i përgjithshëm i ZKM-së dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të shqyrtojnë dy rastet e mësipërme dhe të konfirmojnë nëse fjala është për dy projekte të ndara. Në të kundërtën, shumat e përfituara në mënyrë të pa drejtë nga OJQ, t'i kthehen buxhetit të ZKM, dhe zyra për qeverisje të mire të monitoroj procese dhenjese se subvencioneve në menyr që të parandalohet dhenja e tyre pa i përmbushur detyrimete nga marrveshja paraprake.		
6	Subvencione t dhe transferet	Rekomandimi A3 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të siguroj që të respektohet korniza ligjore në fuqi, respektivisht të mos shpall thirrje publike, para se fondet buxhetore të jenë të disponueshme në llogari bankare.		

7	Obligimet e paguara	Rekomndimi B3 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që obligimet e mbetura në fund vit duhet të raportohen saktë në PFV, dhe të gjitha faturat të dorëzohen me kohë në shërbimin e financave.
8	NJAB	Rekomndimi A4 Kryeshefi i AUV duhet të mbështetë dhe ndihmoj aktivitetet operative në vazhdim, si dhe të siguroj pjesëmarrjen e AB në takimet e Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO ЗНАЧЕЊА КРИСОВЕС - ВЛАДА КОСОВА - GOVERNMENT OF KOSOVO ЗНАЧЕЊА КРИСОВЕС - ВЛАДА КОСОВА - GOVERNMENT OF KOSOVO SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Dokumentit / Org. Unit 02	Nr. Prot. / Prot. No. 146813
Nr. i dërgimit / Nr. pages 1	Data / Datum / Date 13 / 06 / 20 19
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

Datë: 12.06.2019

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

Z. Fitim Krasniqi

Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit

Data: 12 qershor 2019, Prishtinë,